

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.16.01.2023*

16.01.2023

Ora 15:10

**RENDI I DITËS**

*Hedhja e shortit për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 16, me ankues Partia Fryma e Re Demokratike, me objekt: Kundërshtim i vendimit nr.224 datë, 07.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema

*Z. Y. Merkaj:* Përshëndetje të gjithëve! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 16.01.2023 është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 16 me ankues Partia Fryma e Re Demokratike, e cila kundërshton vendimin nr.224 datë, 07.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 prill 2021”. Referuar nenit 14 të Rregullores së KAS-it, procedura e shortit është e njëjtë si herët e kaluara. Kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njërin prej tyre është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 16, katër të tjerat janë të bardha dhe pa shënime, të cilat palosen dhe futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë të cilat vendosen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent në procedurën e shortit, kanë autorizuar një përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Anëtari për të cilin tërhiqet gogla që mbart

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.16.01.2023*

numrin e ankimit do të jetë relatori i kërkesës ankimore. Pasi janë vendosur të pesë goglat në enën transparente, përziejhen dhe tërhiqen nga përfaqësuesi i KQZ-së dhe: Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Kërkesa Ankimore nr. 16.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatori i Kërkesës Ankimore nr. 16 është zoti Elvin Lako, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

